REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E SHËNDETËSISË-MINISTARSTVO ZDRAVLJA-MINISTRY OF HEALTH

Njësia Org. / Org.Jedinica / Org Unit: 01
Nr.Prot: / Broj Prot: / Prot.No: 05-2659
Nr.i faqeve / Br.stranica / No.pages: ~10~
Data: / Datum: / Date: 21.04.2021
Prishtinë / a

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
***Qeveria-Vlada-Government***
Ministria e Shëndetësisë-Ministarstvo Zdravstva-Ministry of Health
Zyra e Ministrit/Ured Ministra/Office of the Minister

Nr. 227/IV/2021
Datë:20.04.2021

Ministri i Ministrisë së Shëndetësisë, në mbështetje të nenit 10 dhe 11 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (GZ Nr. 7, 01 mars 2019), nenin 8 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, bazuar në nenin 5 paragrafi 2 nënparagrafi 2.5 të Ligjit Nr. 07/L-006 për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë Covid-19 në Territorin e Republikës së Kosovës (GZ Nr. 3/2020, 25 gusht 2020), nenin 9 paragrafi 1.3 dhe nenin 89 të Ligjit nr.04/L-125 për Shëndetësi (GZ Nr. 13/2013, 07 maj 2020), në zbatim të Vendimit Nr. 01/11 të datës 15.03.2020 për Shpalljen e Emergjencës së Shëndetit Publik dhe të pikës 42 dhe 42 të Vendimit Nr.01/07 të datës 18.04.2021 për Masat e Përgjithshme dhe të Veçanta për Kontrollin, Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë COVID-19, nxjerr:

# VENDIM

## Për aprovimin e Udhëzuesit të përkohshëm - Aplikimi i masave të përgjithshme dhe të veçanta për parandalimin dhe luftimin e COVID-19 në sektorin e shërbimeve personale, bizneseve, industrisë, administratës publike dhe OJQ-ve

1. Aprovohet Udhëzuesi i përkohshëm - Aplikimi i masave të përgjithshme dhe të veçanta për parandalimin dhe luftimin e COVID-19 në sektorin e shërbimeve personale, bizneseve, industrisë, administratës publike dhe OJQ-ve (verzioni 1.0)

2. Udhëzuesi është i obligueshëm për të gjithë personat dhe sektorët ndaj të cilëve zbatohet.

3. Shtojca e bashkangjitur këtij vendimi, është pjesë përbërëse e tij.

4. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm që përmes Qarkores Informative të informoj të gjitha institucionet dhe palët e interesit për aprovimin e këtij udhëzuesi.

5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Ministri i Shëndetësisë.

**Dr. Arben Vitia**
**Ministër i Shëndetësisë**

Vendim i dërgohet:

- Zyrës së Kryeministrit;
- Të gjitha ministrive
- Sekretarit të Përgjithshëm të MSh;
- Departamentit ligjor të Msh;
- Divizionit për komunikim me publikun të Msh;
- Arkivit të MS

**Shtojca 1:** Udhëzues i përkohshëm - Aplikimi i masave të përgjithshme dhe të veçanta për parandalimin dhe luftimin e COVID-19 në sektorin e shërbimeve personale, bizneseve, industrisë, administratës publike dhe OJQ-ve (verzioni 1.0)

*Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo*
*Qeveria - Vlada - Government*
*Ministria e Shëndetësisë / Ministarstvo Zdravstva / Ministry of Health*

# UDHËZUES I PËRKOHSHËM APLIKIMI I MASAVE TË PËRGJITHSHME DHE TË VEÇANTA PËR PARANDALIMIN DHE LUFTIMIN E COVID-19 NË SEKTORIN E SHËRBIMEVE PERSONALE DHE BIZNESEVE, INDUSTRISË, ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE OJQ-VE

**Prishtinë, Prill 2021**

**Verzioni 1.0**

## Udhëzime specifike të parandalimit të përhapjes së COVID-19 në sektorin e shërbimeve personale

### 1. Promovoni dhe respektoni distancën fizike

- Siguroni distancën fizike prej 2 metra për të gjithë stafin në të gjithë vendin e punës dhe gjatë periudhave të ngrënies dhe pushimit (p.sh.,dhomat e punës, dhomat e drekës, dhomat e ndërrimit, banjot).
- Organizoni vendet e punës për të mbajtur një distancë fizike prej 2 metra midis zonave të shërbimit të klientëve.
- Kufizoni numrin e stafit dhe të kontraktorëve/klientëve të pranishëm në vendin e punës në çdo kohë të caktuar sipas vendimeve të Qeverisë së Kosovës.
- Krijoni një orar terminesh paraprakisht, në mënyrë që të shmangni grumbullimin e klientëve në hapësirat e brendshme, kur distanca fizike nuk është e mundur.
- Mos lejoni që klientët tuaj të sjellin persona shoqërues në vendet tuaja të punës.

### 2. Mbani dhe inkurajoni higjienën e duarve

- Siguroni sapun dhe ujë në vendin e punës. Nëse sapuni dhe uji nuk janë në dispozicion përdorni dezinfektues duarsh me bazë alkooli 60-70%. Nëse duart janë dukshëm të ndotura, sapuni dhe uji duhet të zgjidhen para dezinfektuesve. Sigurohuni që të keni sasi adekuate në dispozicion.
- Sigurohuni që duart të lahen/fërkohen për të paktën 20 sekonda dhe kufizoni kontaktet me sipërfaqet dhe mjetet e pëbashkëta.
- Pastroni duart me ujë apo deznifektues menjëherë pas ofrimit të shërbimit.
- Vendosni dezinfektuesit e duarve në shumë vende për të inkurajuar higjienën e duarve.
- Siguroni furnizim adekuat me sapun të lëngshëm, peshqir letre, pastrues dore, faculeta dhe kosh mbeturinash në të gjithë vendin e punës dhe në banjo.
- Nëse përdoren dorëza, është e rëndësishme t'i ndërroni ato për çdo orë, ose më shpesh, sipas nevojës (p.sh. kur ndërroni detyrat ose ndërmjet klientëve).
- Përdorni opsione pagese me kartelë kur është e mundur. Nëse kjo nuk është e mundur, sigurohuni që paratë dhe kartat të trajtohen me kujdes nga punonjësit ose duke ndërruar doreza midis secilës transaksion ose duke përdorur mjete pastruese midis klientëve.

### 3. Mbani dhe inkurajoni mbajtjen e maskës/mbulesës së fytyrës për stafin dhe klientët

- Sektori i shërbimeve personale duhet të sigurojë që çdo person duke përfshirë stafin dhe klientët në vendet e punës, të vendosin një maskë ose të mbulojnë fytyrën në një mënyrë që mbulon hundën, gojën përderisa janë në hapsirën e brendshme.
- Maskat/mbulesat e fytyrës nuk kanë nevojë të vendosen nga punonjësit në zona të brendshme nëse:

- Jo të gjithë klientët janë në gjendje të mbajnë një maskë dhe në këtë rast mund të lirohen të mos përdorin. Për shembull, maskat nuk duhet të përdoren nga fëmijët nën moshën dy vjeç, dhe personat që kanë probleme me frymëmarrjen.
- Maska nuk është zëvendësim për distancën fizike dhe ajo duhet mbajtur edhe kur arrihet distanca prej 2 metrash, sidomos në hapsira të brendshme.

- Sektori i shërbimeve personale duhet të shfaq rregullat për vendosjen e maskës si masë obligative në hapësirën e tyre të brendshme.

## 4. Përdorimi i pajisjeve personale mbrojtëse (PPM)

- Pajisjet e duhura personale mbrojtëse (PPM) që mbulojnë hundën, sytë dhe gojën duhet të vendosen nëse gjatë ofrimit të shërbimit në një zonë/hapësirë të brendshme, personit i kërkohet të vijë brenda dy metrave nga një person tjetër i cili nuk ka të vendosur maskë ose mbulesë fytyre dhe nuk ndahen nga xhamat mbrojtës ose ndonjë pengesë tjetër.
- Duhet të vendoset një mburojë fizike ndërmjet stafit dhe klientëve kur shërbimet ofrohen ballë për ballë (p.sh., manikyrët, gërryerja e mikrodermës, aplikimi i make up e të tjera).
- Mburojat fizike mund të modifikohen për të lejuar që duart të kalojnë poshtë, por parandalojnë transmetimin e spërklave.
- Kur mburojat fizike nuk janë të mundshme, pritet që punëtori të vendosë maskë dhe duhe të kërkohet edhe nga klientët që të vendosin maskën gjatë ofrimit të shërbimit.

## 5. Zbatimi i masave të pastrimit dhe dezinfektimit

- Zbatoni pastrimin dhe dezinfektimin rigoroz të shpeshtë të mjedisit në të gjitha vendet ku preken (si dorezat e dyerve, banakët, dyert e kabinetit, butonat e ashensorit, çelsat e dritës, rubinetat, dorezat e tualetit, shinat e duarve, sipërfaqet e ekranit me prekje dhe zonat e tastierës) dhe zonat që janë të arritshme për klientët, përfshirë banjot, banakët e daljeve, dhe sipërfaqe të tjera ku preken me duar, siç janë dorezat e derës.
- Pajisjet dhe mjetet që duhet të ndahen midis përdoruesve duhet të pastrohen dhe dezinfektohen rregullisht (p.sh. krehërit, gërshërët, vendet e arkëtarëve, makineritë).
- Nëse stafi ndahet në grupe të caktuara, pastroni dhe dezinfektoni hapësirat e përbashkëta midis grupeve zëvëndësuese.
- Lani peshqirët, rrobat dhe sendet e ngjashme që mund të përdoren ndërmjet klientëve, dhe hidhni sendet që nuk lahen menjëherë pas çdo shërbimi.
- Thani sendet e pastruara plotësisht në një temperaturë të lartë.
- Përdorni vetëm pajisje që mund të pastrohen dhe dezinfektohen, ose asgjësohen midis termineve të klientëve.
- Faculetat pastruese/dezinfektuese duhet të përdoren vetëm për sipërfaqet, dhe sipas udhëzimeve të prodhuesit.
- Përdorimi i duhur i agjentëve pastrues dhe dezinfektues, përfshirë kohën e nevojshme të kontaktit me dezinfektuesin (sasia e kohës që produkti i duhet të mbetet i lagësht në një sipërfaqe për të punuar në mënyrë efektive).

## 6. Mirëmbani sistemet e ngrohjes, ventilimit dhe kondicionimit të ajrit

- Punëdhënësi duhet të kryejë një rishikim të rregullt të sistemeve të ngrohjes, ventilimit dhe kondicionimit të ajrit për t'u siguruar që ato funksionojnë si duhet.
- Rritni qarkullimin e ajrit të jashtëm duke maksimizuar raportin e ajrit të jashtëm ose duke hapur dritare dhe dyer, kur është e mundur.
- Shmangni riciklimin e ajrit.

# 7. Modeli i funksionimit në konteksin e COVID-19

## 7.1 Kapaciteti i kufizuar

Bizneset dhe objektet e hapura për publikun duhet të kufizojnë numrin e personave në objekt në mënyrë që:

- Klientët dhe punonjësit të jenë në gjendje të mbajnë të paktën 2 metra distancë fizike me kapacitet të kufizuar.
- Numri maksimal i personave duhet të jetë 1 person pwe metwr katror, gjithmonë duke respektuar masat e përgjithshme për parandalim të përhapjes së COVID-19.

## 7.2 Modifikimi i ofrimit të shërbimeve sipas situatës

- Krijoni një orar për ofrimin e shërbimeve duke reduktuar numrin e stafit dhe klientëve të pranishëm në objekt.
- Anuloni veprimtarinë tuaj kur distanca ose masat e tjera të rekomanduara nuk mund të zbatohen.

## 7.3 Konsiderata ndaj stafit

- Nëse stafi juaj dyshohet të ketë COVID-19, personi duhet të izolohet pavarësisht nëse ka simptoma apo jo.
- Nëse stafi juaj ka qenë i ekspozuar ndaj COVID-19, personi duhet të qëndojë në shtëpi dhe të respektojë rekomandimet nga IKSHPK (https://niph-rks.org/) dhe MSh https://msh.rks-gov.net/sq/

## 7.4 Ngritja e vetëdijes për shëndetin publik dhe komunikimi me stafin

- Siguroni informatat për stafin dhe klientët lidhur me aktivitetet e biznesit tuaj ( psh masat e shëndetit publik, pajisjet e disponueshme, rregullat e biznesit tuaj) përmes platformave të ndryshme të komunikimit (psh. media, materiale informuese).
- Sigurohuni që materialet informuese të vendosen në mjedise me shikueshmëri të lartë për të promovuar mesazhe si të mbroheni nga COVID-19.
- Informoni stafin dhe klientët në lidhje me masat që merren për t'i mbrojtur ata nga COVID-19 dhe sigurohuni që ata i kanë kuptuar

## 7.5 Plani i sigurisë

Të gjitha bizneseve dhe vendeve të punës u kërkohet të përgatisin dhe të vënë në dispozicion një plan sigurie si në vijim:

- Të përshkruani masat/procedurat që janë zbatuar ose do të zbatohen në biznesin ose institucionin/organizatën tuaj për të zvogëluar përhapjen e COVID-19.
- Të përfshini masat për distancën fizike, maskat, pastrimin dhe dezinfektimin e sipërfaqeve dhe objekteve dhe mbajtjen e pajisjeve mbrojtëse personale (PPM).
- Të vendosen shenjëzimet për distancë fizike para secilit objekt/lokal/hapësirë në dysheme/tokë ku specifikohet distanca fizike prej 2 metra.
- Caktoni një person përgjegjës për zhvillimin dhe zbatimin e planit të sigurisë, i cili do të bëj vlerësimin e stafit/klientëve/palëve për ndonjë simptomë eventuale të COVID-19

## Udhëzime specifike të parandalimit të përhapjes së COVID-19 në sektorin e bizneseve, industrisë, administratës publike dhe OJQ-ve

### 8. Promovoni dhe respektoni distancën fizike

- Siguroni distancën fizike prej 2 metra për të gjithë stafin në të gjithë vendin e punës dhe gjatë periudhave të ngrënies dhe pushimit (p.sh.,dhomat e punës, dhomat e drekës, dhomat e ndërrimit, banjot).
- Organizoni vendet e punës për të mbajtur një distancë fizike prej 2 metra midis zonave të shërbimit të klientëve.
- Kufizoni numrin e stafit dhe të kontraktorëve/klientëve të pranishëm në vendin e punës në çdo kohë të caktuar sipas vendimeve të Qeverisë së Kosovës.
- Krijoni një orar terminesh paraprakisht, në mënyrë që të shmangni grumbullimin e klientëve në hapësirat e brendshme, kur distanca fizike nuk është e mundur.
- Mos lejoni që klientët tuaj të sjellin persona shoqërues në vendet tuaja të punës.

### 9. Mbani dhe inkurajoni higjienën e duarve

- Siguroni sapun dhe ujë në vendin e punës. Nëse sapuni dhe uji nuk janë në dispozicion përdorni dezinfektues duarsh me bazë alkooli 60-70%. Nëse duart janë dukshëm të ndotura, sapuni dhe uji duhet të zgjidhen para dezinfektuesve. Sigurohuni që të keni sasi adekuate në dispozicion.
- Sigurohuni që duart të lahen/fërkohen për të paktën 20 sekonda dhe kufizoni kontaktet me sipërfaqet dhe mjetet e pëbashkëta.
- Pastroni duart me ujë apo deznifektues menjëherë pas ofrimit të shërbimit.
- Vendosni dezinfektuesit e duarve në shumë vende për të inkurajuar higjienën e duarve.
- Siguroni furnizim adekuat me sapun të lëngshëm, peshqir letre, pastrues dore, faculeta dhe kosh mbeturinash në të gjithë vendin e punës dhe në banjo.
- Nëse përdoren dorëza, është e rëndësishme t'i ndërroni ato për çdo orë, ose më shpesh, sipas nevojës (p.sh. kur ndërroni detyrat ose ndërmjet klientëve).
- Përdorni opsione pagese me kartelë kur është e mundur. Nëse kjo nuk është e mundur, sigurohuni që paratë dhe kartat të trajtohen me kujdes nga punonjësit ose duke ndërruar doreza midis secilës transaksion ose duke përdorur mjete pastruese midis klientëve.

### 10. Mbani dhe inkurajoni mbajtjen e maskës/mbulesës së fytyrës për stafin dhe klientët

- Sektori i shërbimeve personale duhet të sigurojë që çdo person duke përfshirë stafin dhe klientët në vendet e punës, të vendosin një maskë ose të mbulojnë fytyrën në një mënyrë që mbulon hundën, gojën përderisa janë në hapsirën e brendshme.
- Maskat/mbylesat e fytyrës nuk kanë nevojë të vendosen nga punonjësit në zona të brendshme nëse:

- Jo të gjithë klientët janë në gjendje të mbajnë një maskë dhe në këtë rast mund të lirohen të mos përdorin. Për shembull, maskat nuk duhet të përdoren nga fëmijët nën moshën dy vjeç, dhe personat që kanë probleme me frymëmarrjen.
- Maska nuk është zëvendësim për distancën fizike dhe ajo duhet mbajtur edhe kur arrihet distanca prej 2 metra, sidomos në hapsira të brendshme.

- Sektori i shërbimeve personale duhet të shfaq rregullat për vendosjen e maskës si masë obligative në hapësirën e tyre të brendshme.

## 11. Përdorimi i Pajisjeve personale mbrojtëse (PPM)

- Pajisjet e duhura personale mbrojtëse (PPM) që mbulojnë hundën, sytë dhe gojën duhet të vendosen nëse gjatë ofrimit të shërbimit në një zonë/hapësirë të brendshme, personit i kërkohet të vijë brenda dy metrave nga një person tjetër i cili nuk ka të vendosur maskë ose mbulesë fytyre dhe nuk ndahen nga xhamat mbrojtës ose ndonjë pengesë tjetër.
- Duhet të vendoset një mburojë fizike ndërmjet stafit dhe klientëve kur shërbimet ofrohen ballë për ballë (p.sh., manikyrët, gërryerja e mikrodermës, aplikimi i make up e të tjera).
- Mburojat fizike mund të modifikohen për të lejuar që duart të kalojnë poshtë, por parandalojnë transmetimin e spërklave.
- Kur mburojat fizike nuk janë të mundshme, pritet që punëtori të vendosë maskë dhe duhe të kërkohet edhe nga klientët që të vendosin maskën gjatë ofrimit të shërbimit.

## 12. Zbatimi i masave të pastrimit dhe dezinfektimit

- Zbatoni pastrimin dhe dezinfektimin rigoroz të shpeshtë të mjedisit në të gjitha vendet ku preken (si dorezat e dyerve, banakët, dyert e kabinetit, butonat e ashensorit, çelsat e dritës, rubinetat, dorezat e tualetit, shinat e duarve, sipërfaqet e ekranit me prekje dhe zonat e tastierës) dhe zonat që janë të arritshme për klientët, përfshirë banjot, banakët e daljeve, dhe sipërfaqe të tjera ku preken me duar, siç janë dorezat e derës.
- Pajisjet dhe mjetet që duhet të ndahen midis përdoruesve duhet të pastrohen dhe dezinfektohen rregullisht (p.sh. krehërit, gërshërët, vendet e arkëtarëve, makineritë).
- Nëse stafi ndahet në grupe të caktuara, pastroni dhe dezinfektoni hapësirat e përbashkëta midis grupeve zëvëndësuese.
- Lani peshqirët, rrobat dhe sendet e ngjashme që mund të përdoren ndërmjet klientëve, dhe hidhni sendet që nuk lahen menjëherë pas çdo shërbimi.
- Thani sendet e pastruara plotësisht në një temperaturë të lartë.
- Përdorni vetëm pajisje që mund të pastrohen dhe dezinfektohen, ose asgjësohen midis termineve të klientëve.
- Faculetat pastruese/dezinfektuese duhet të përdoren vetëm për sipërfaqet, dhe sipas udhëzimeve të prodhuesit.
- Përdorimi i duhur i agjentëve pastrues dhe dezinfektues, përfshirë kohën e nevojshme të kontaktit me dezinfektuesin (sasia e kohës që produkti i duhet të mbetet i lagësht në një sipërfaqe për të punuar në mënyrë efektive).

### 13. Mirëmbani sistemet e ngrohjes, ventilimit dhe kondicionimit të ajrit

- Punëdhënësi duhet të kryejë një rishikim të rregullt të sistemeve të ngrohjes, ventilimit dhe kondicionimit të ajrit për t'u siguruar që ato funksionojnë si duhet.
- Rritni qarkullimin e ajrit të jashtëm duke maksimizuar raportin e ajrit të jashtëm ose duke hapur dritare dhe dyer, kur është e mundur.
- Shmangni riciklimin e ajrit.

## Modeli i funksionimit në konteksin e COVID-19

### 14. Kapaciteti i kufizuar

Bizneset dhe objektet e hapura për publikun duhet të kufizojnë numrin e personave në objekt në mënyrë që:

- Klientët dhe punonjësit të jenë në gjendje të mbajnë të paktën 2 metra distancë fizike me kapacitet të kufizuar.
- Numri maksimal i personave duhet të jetë 1 person në 8 metra katrorë, gjithmonë duke respektuar masat e përgjithshme për parandalim të përhapjes së COVID-19.

### 15. Modifikimi i ofrimit të shërbimeve sipas situatës

- Krijoni një orar për ofrimin e shërbimeve duke reduktuar numrin e stafit dhe klientëve të pranishëm në objekt.
- Anuloni veprimtarinë tuaj kur distanca ose masat e tjera të rekomanduara nuk mund të zbatohen.

### 16.Konsiderata ndaj stafit

- Nëse stafi juaj dyshohet të ketë COVID-19, personi duhet të izolohet pavarësisht nëse ka simptoma apo jo.
- Nëse stafi juaj ka qenë i ekspozuar ndaj COVID-19, personi duhet të qëndojë në shtëpi dhe të respektojë rekomandimet nga IKSHPK (https://niph-rks.org/) dhe MSh https://msh.rks-gov.net/sq/

### 17. Ngritja e vetëdijes për shëndetin publik dhe komunikimi me stafin

- Siguroni informatat për stafin dhe klientët lidhur me aktivitetet e biznesit tuaj (psh masat e shëndetit publik, pajisjet e disponueshme, rregullat e biznesit tuaj) përmes platformave të ndryshme të komunikimit (psh. media, materiale informuese).
- Sigurohuni që materialet informuese të vendosen në mjedise me shikueshmëri të lartë për të promovuar mesazhe si të mbroheni nga COVID-19.
- Informoni stafin dhe klientët në lidhje me masat që merren për t'i mbrojtur ata nga COVID-19 dhe sigurohuni që ata i kanë kuptuar.

## 18.Plani i sigurisë

Të gjitha bizneseve dhe vendeve të punës u kërkohet të përgatisin dhe të vënë në dispozicion një plan sigurie si në vijim:

- Të përshkruani masat/procedurat që janë zbatuar ose do të zbatohen në biznesin ose institucionin/organizatën tuaj për të zvogëluar përhapjen e COVID-19.
- Të përfshini masat për distancën fizike, maskat, pastrimin dhe dezinfektimin e sipërfaqeve dhe objekteve dhe mbajtjen e pajisjeve mbrojtëse personale (PPM).
- Të vendosen shenjëzimet për distancë fizike para secilit objekt/lokal/hapësirë në dysheme/tokë ku specifikohet distanca fizike prej 2 metra.
- Caktoni një person kryesor që do të jetë përgjegjës për zhvillimin dhe zbatimin e planit të sigurisë.